

Të dashur Prindër dhe Kujdestarë,

Në ditët e fundit, sulmet e izoluara në administratorët e shkollave kanë çuar në një shqetësim të shtuar në komunitetet tona shkollore. Drejtoria Arsimore e Filadelfias angazhohet për sigurinë dhe mirëqenien e studentëve dhe stafit të saj. Sulmi ndaj dy administratorëve të respektuar nuk është i pranueshëm dhe nuk mund të tolerohet. Prindërit janë partnerët tanë kryesorë në edukimin e fëmijëve të tyre dhe për këtë arsye ne punojmë për të siguruar angazhimin e tyre të respektueshëm në shkolla. Ndërsa mund të kemi dallime, sulmet fizike nuk do të lejohen. Ne po e ndjekim këtë çështje në mënyrë aktive me autoritetet e sigurisë publike dhe po bashkëpunojmë plotësisht me hetimet.

Ndërsa forcojmë përpjekjet tona midis shkollës, familjes dhe komunitetit, ne gjithashtu kemi nevojë për ndihmën tuaj. Në qoftë se ju kërkoni mbështetjen, ose ndihmë për nxënësin tuaj në shkollat tona, ju lutemi telefononi Zyrën për Angazhimin e Familjes dhe Komunitetit në numrin: (215) 400 - 4000; email: ask@philasd.org; ose të kërkoni një takim me koordinatorin për angazhimin e familjes të shkollës tuaj.

Qëndrimi si një komunitet i përbashkët për të zgjidhur shqetësimet do të na ndihmojë të sigurojmë që nxënësit të jenë të sigurtë dhe të na lejojë të vazhdojmë punën e rëndësishme të arsimit.

Me respekt,

Drejtoria Arsimore e Filadelfias